



---

## Asociacioni I Komunave të Kosovës

### Raport nga

### Takimi i Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

I mbajtur më datën 06 deri më datën 07 Tetor 2011

Tiranë/ Shqipëri

**Për:** Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

**Nga:** Arta Berisha Bajrami – Koordinatore në AKK

**Lënda:** Raport nga takim i Kolegjiumit për Mirëqenie Sociale



## Hyrje

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takimin e radhës së Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, kryesuar nga Kryesuesi i Mirëqenies Sociale Z. Bashkim Hyseni dhe Menaxheri i Programit i AKK-së z. Ertan Munoglu, i mbajtur nga data 05 deri më 07 Tetor 2011 në Hotel " DORO" – Tiranë/Shqipëri. Në këtë takim morën pjesë Drejtorët për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përfaqësues nga Qendrat për Punë Sociale nga Komunitet Ferizaj, Prizren, Prishtinë, Obiliq, Mitrovicë, Pejë, Istog, Klinë, Lipjan, Rahovec, Dragash, Suharekë, Mamush, Hani i Elezit, Novobërdë, dhe Podujevë. Në këtë takim po ashtu morën pjesë përfaqësuesit nga projekti i DIFID-it, stafi i AKK-së dhe dy ministritë relevante: MAPL dhe MPMS të cilat prezantuan rreth decentralizimit të shërbimeve sociale.

Rendi i ditës ishte përcaktuar më parë nga Kryesia e Kolegjiumit me këto pika: qasja e qeverisë në procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale si dhe shqyrtimi i rekomandimeve dhe konkluzioneve të arritura gjatë punës rajonale të mbajtura në 5 rajone Ferizaj, Prizren, Prishtinë, Mitrovicë, Pejë nga data 19 – 23 shtator 2011, për të shqyrtuar sfidat dhe vështirësitë pas decentralizimit të shërbimeve sociale.

### Prezantim nga përfaqësuesi i MAPL-së z. Fatos Qerimi - Udhëheqës i Divizionit për RPL

Nga ky prezantim është paraqitur procesi i reformës së pushtetit lokal, misioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal duke përfshirë qëllimin, koordinimin ndërministrorë, sigurimi i burimeve të mjaftueshme për realizimin e kompetencave komunale, njoftimi me standardet dhe praktikën më të mira të BE-së dhe koordinimi në implementimin e prioritetëve, monitorimi dhe mbikëqyrja e kompetencave të komunave dhe ligjshmëria, përmirësimi i kualitetit të shërbimeve komunale. U prezantua Reformimi I Pushtetit Lokal - decentralizimi (Rregulloret, Ligjet), Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për kufijtë administrative të Komunave, Plani i Veprimit për Kufijtë administrativ të Komunave, Plani i veprimit për Decentralizim, Kompetencat vetanake dhe të bartura, Marrëveshja e mirëkuptimit për bartje të kompetencave të shërbimeve sociale dhe delegimi i përgjegjësive të ndihmave sociale, etj. Pas këtij prezantimi pati diskutime për zbatueshmërinë e rregulloreve dhe legjislacionit, për më shumë informata gjëni të bashkangjitur prezantimin.

### Prezantim nga përfaqësuesi i DMS – Z. Bajram Kelmendi – Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Sociale në MPMS.

Përfaqësuesi nga DMS-ja prezantoi zhvillimin e shërbimeve sociale pas Luftës në Kosovë deri te procesi i decentralizimit. Procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale është bërë nga viti 2009 ku është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit dhe nga ky moment të gjitha kompetencat kanë kaluar në nivel komunal. Decentralizimi është bërë si vendim politik dhe është bërë pa përgatitje, pra të gjitha përgjegjësitë për shërbimet sociale i kanë kaluar komunave, të cilat nuk kanë qenë të gatshme për ta pranuar këtë proces. Projekti i cili është paraparë nga Ministria për të trajnuar Komunitet ka dështuar, andaj do të mundohemi ta kompensojmë kohën dhe do ta mbështesim Komunitetin pasi i ka të gjitha kompetencat, mirëpo përkrahja e partnerëve ndërkombëtar mund të ndihmojë shumë në këtë proces. Deri më tani nuk është bërë asnjë lëvizje në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve të komunave. Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk është profesionalisht e gatshme për përgjegjësitë që i ka për

shërbimet sociale, prandaj nevojiten trajnime për shërbimet sociale, pastaj staf profesional, buxhet të mjaftueshëm për realizimin e kërkesave nga ana e Qendrave për punë Sociale, të gjitha me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale sa më adekuate tek qytetarët. Z. Kelmendi propozoi që duhet të trajnohet stafi udhëheqës i DSHMS-së, nëpunësit komunal (sektori i shërbimeve sociale), stafi profesional i QPS-ve, të gjitha bashkarisht me partnerët sepse shërbimet sociale nuk mund të ofrohen pa partner (p.sh. policia, gjykata, OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale). Po ashtu u theksua rëndësia e ruajtjes së konfidencialitetit nga ana e QPS-ve, sepse kjo është përcaktuar me ligjin për Shërbimet Sociale Familjare. QPS-të duhet të raportojnë në Komuna për numrin e rasteve të shërbimeve, por jo me emra.

Në pyetjet e të pranishmëve se cilat shërbime janë të centralizuara apo decentralizuara, u përmend se shërbimi për të moshuarit, ndihmat sociale dhe transferet tjera për përfituesit nuk janë decentralizuar. Gjatë diskutimeve të përbashkëta z. Kelmendi shprehu se Komunitat duhet të kenë informata të plota rreth infrastrukturës ligjore dhe marrëveshjes së bashkëpunimit; mirëpo edhe QPS-të nuk kanë përmbushur obligimin për të dhënë informatat e nevojshme nivelit komunal.

Komuna duhet të organizoj trajnime për stafin e brendshëm por në rast të punësimit të punëtorëve të rinjë ekzistojnë doracakët të cilët udhëzojnë dhe informojnë stafin. Për t'u informuar më lehtë ekziston Udhëzimi Administrativ për shërbimet sociale ku janë të përshkruara procedurat dhe statusi i shërbimeve sociale (nevojitet trajnim për zbatimin e këtij UA) - procedurat në këtë udhëzim administrativ përshkruhen qartë nga prezantimi i rastit e deri tek ofrimi i shërbimeve sociale apo përfundimi i rastit.

Në aspektin financiar pas decentralizimit QPS-të nuk duhet të bëjnë kërkesë në MPMS por në Komunë, pastaj Komuna në Ministri të Financave. Kryesuesi i Kolegjiut z. Bashkim Hyseni theksoi se MPMS asnjëherë nuk ka kërkuar takim me DSHMS në lidhje me këtë proces, mirëpo z. Kelmendi u përgjigj se MPMS nuk është e obliguar për të trajnuar Komunitat (është e përcaktuar edhe me ligj) sepse ngritja e kapaciteteve të Komunave është obligim i MAPL-së.

U diskutua edhe raportimi, gjë që është e përcaktuar edhe me Ligjin për Shërbimet Sociale Familjare. DSHMS-të kanë për obligim përgatitjen e planit vjetor dhe raporteve vjetore të cilat MPMS-ja duhet t'i miratoj. Në fund z. Kelmendi ka shprehur gatishmërinë e plotë të bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës për ngritjen e kapaciteteve të Komunave për ofrimin e shërbimeve sociale.

Përfaqësuesi nga Ministria e Financave – askush nga kjo Ministri nuk ka marr pjesë në këtë takim.

#### Prezantime të shkurtra nga 5 Komisionet rajonale

Komisionet rajonale prezantuan sfidat dhe vështirësitë gjatë punës së tyre në baza rajonale, si dhe komentuan rekomandimet dhe konkluzionet e arritura nga punëtoritë e mbajtura në 5 rajone: Ferizaj, Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë. Gjatë prezantimeve u diskutua për mangësitë dhe problemet pas decentralizimit të shërbimeve sociale si: mungesa e buxhetit për shërbime sociale, rritja e stafit, trajnime profesionale për stafin komunal, ngritja e komunikimit QPS- Komunë, ndarja e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale në drejtoritë komunale, statusi i QPS-ve, mungesa e logjistikës etj...

### Prezantim nga Yuriy Dzhygyr - Përfaqësues nga projekti i DFID-it

Në këtë prezantim është paraqitur dizajni i mekanizmit financues për ndarjen e resurseve për shërbimet e kujdesit social në Kosovë si dhe kriteret dhe opsionet e mundshme në këtë drejtim. Për më shumë informata gjeni të bashkangjitur prezantimin.

### Prezantim nga Sharr Kurtishi - Përfaqësues nga projekti i DFID-it

Nga ky prezantim është paraqitur financimi i shërbimeve sociale gjatë 3 viteve të fundit, çfarë kuptojmë me koston për njësi, përbërja e koston, si dhe arritja e përcaktimit të koston për njësi për shërbimet sociale. Është prezantuar transferi i shërbimeve sociale në nivel komunal në aspektin financiar, duke përfshirë transferin e financimit për: 1. Qendrat për Punës Sociale, 2. personelin i cili ofron shërbimet sociale, 3. pajisjet, 4. asetet fikse, etj. Për më detajisht gjeni të bashkangjitur prezantimin.

Takimi me përfaqësuesen znj. Ilda Bozo – Drejtoreshë e Departamentit për Monitorimi në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shqipërisë. Znj. Bozo prezantoi sistemin e ofrimit të shërbimeve sociale në Shqipëri i cili përbëhet nga: sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, pagesat e papunësisë, ndihma ekonomike dhe shërbimet shoqërore. Në aspektin e sigurimeve shoqërore janë dy sisteme të shërbimit: 1. Shërbimi Social Shtetëror ku zhvillohen dhe zbatohen politikat sociale në nivel qendror përmes 12 drejtorive rajonale për inspektim, dhe 2. Sistemi Kombëtar i Punësimit.

Skemat sociale në Shqipëri janë të ndara në dy lloje: 1. Skema për personat me aftësi të kufizuar dhe Skema për familjet e varfra të cilat përfitojnë nga ndihma për të dalur nga varfëria ekstreme. Familja e cila është vlerësuar me varfëri të skajshme pranon skemën e asistencës sociale prej rreth 40 euro në muaj/person, apo në rastet kur familja ka person me aftësi të kufizuar merr asistencën sociale për personin me aftësi të kufizuar 80 euro në muaj. Matja e nivelit të varfërisë deri më tani është bërë 3 herë prej vitit 2003 deri në 2008, dhe me këtë matje janë identifikuar familjet të cilat janë në varfëri të skajshme në bazë të shportës së shpenzimeve përmes anketave.

Ndihmat ekonomike dallon sepse ajo bazohet në të ardhurat e familjes – në rast se të ardhurat e familjes janë të pamjaftueshme, ato suplementohen me ndihmë financiare si dhe kompensim të shpenzimeve të rrymës dhe kompensim shtesë në fund të vitit për fëmijët.

Mjetet alokohen në nivel lokal në bazë të numrit të rasteve (sipas kërkesave të pushtetit lokal) dhe koeficientit të varfërisë (sipas anketave). Për shkak se skema abuzohet mjaft, prandaj ministria ka ndërmarrë regjistrimin e përfituesve përgjatë një muaji dhe rezultatet janë në përpunim e sipër. Mendohet që rreth 15,000 familje përfituese (15%) janë fiktive.

Pas prezantimit ka pasur pyetje të ndryshme në lidhje me ofrimin e shërbimeve si: hartimi dhe zbatimi i politikave, strehimi i fëmijëve të braktisur në bashkëpunim mes Ministrisë së Punës dhe Ministrisë së Ndërtimit e cila ndërton shtëpi strehimi, (si dhuna në familje, familje e varfër pa shtëpi apo kategori të tjera sociale që kanë nevojë për strehim), etj.

Çdo Komunë (Bashkia) ka një drejtor të posaçme që është në kontakt të drejtpërdrejt me familjet, ofron shërbimet sociale dhe menaxhon me mjetet. Stafi në komunë është i profilizuar varësisht prej

shërbimeve të cilat i ofron – por për këtë gjë ekzistojnë edhe standardet të cilat monitorohen rregullisht nga drejtoritë rajonale.

Në fund të takimit u diskutua rreth raportimit të QPS-së në Komunë, disa Komuna kanë shprehur se është e nevojshme raportimi i listave me emra të ofrimit të shërbimeve nga QPS-ja, por disa komuna tjera kanë shprehur që duhet të ruhet konfidencialiteti, ku është e përcaktuar edhe në " Ligjin për shërbimet sociale familjare " . Qendrat për Punë Sociale duhet të raportojnë në komunë për çdo gjë, dhe në rast se ka keqpërdorime, QPS-ja ka për obligim të raportoj në komunë. p.sh Prishtina ka 3 Qendra për punë sociale të cilat raportojnë për çdo 3 muaj.

U diskutua roli i Komisioneve, dhe u vendos që rajonet të mbesin të njëjta, mirëpo të vetorganizohen në baza rajonale, ku duhet të identifikohen nevojat e QPS-ve në infrastrukturë apo kapacitete tjera, dhe të filloj zhvillimi i strategjive për ngritjen e kapaciteteve.

### **Konkluzionet dhe rekomandimet**

- Ngritja e kapaciteteve profesionale
- Trajnime për Drejtorët Komunale për Mirëqenie Sociale ;
- Trajnime për Drejtorët e QPS-ve;
- Trajnime për Shefat Komunal për Mirëqenie sociale;
- Trajnime në aspektin Financiar;
- Trajnime për zbatimin e MM dhe UA;
- Identifikimi i nevojave të QPS-ve në infrastrukturë dhe kapacitete tjera,
- Zhvillimi i strategjisë për ngritjen e kapaciteteve,
- Vet organizimi i Komisioneve në baza regjionale
- Hartimi i rregullores për vazhdimin e punës së Kolegjiumit dhe të Komisioneve,
- Bartja e plot e kompetencave në Komunë (transferet nuk janë bartë),
- Sigurimi i Fondit emergjent për QPS-ët, Transferimi i menaxhimit të buxhetit në nivel lokal,
- Të decentralizohen të gjitha shërbimet sociale,
- Mungesa e pajisjeve të zyrave në QPS,
- Nga mungesa e buxhetit për shërbimet sociale – punëtorët social janë të detyruar të shpenzojnë nga pagat e tyre p.sh për fëmijët e braktisur ose për ndonjë kategori tjetër në rast ofrimit të shërbimit të menjëhershëm,
- Kriteret e nevojshme për punësimin e stafit profesional, dhe
- Statusi i QPS-së.

